UNIVERSITETI I PRISHTINËS ''HASAN PRISHTINA'' PRISHTINË
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIKE DHE SPORTIT

PUNIM MASTER

Vlerësimi i ndërmjet hapësirës antropometrike, motorike dhe motorikës situacionale në sportin e hendbollit tek nxënësit e klasës se VII, VIII dhe IX, në Komunën e Drenasit.

MENTORI:
Prof.Ass Dr. Afrim Koca

KANDIDATI:
Sylë Berisha

Prishtinë 2018

PËRMBAJTJA:

1.Hyrje.....4
1.1. Hulumtimet e deritanishme.....5
2. Qëllimi i hulumtimit.....8
2.1. Hipotezat themelore.....9
3. Metodat e punës.....10
3.1. Mënyra e zbatimit të punimit 10
3.2. Instrumentet matëse të variablave antropometrike.....10
3.2.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike.....11
3.3. Grupi i instrumenteve matëse të variablave të motorikës
bazike dhe motorikës situacionale 15
3.3.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike bazike
dhe situacionale……16
4. Metoda dhe përpunimi i rezultateve..... ....….21
5. REZULTATET DHE DISKUTIMET.....22
5.1. Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike
dhe motorike në matjet e nxënësve 22
5.1.1.Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike
dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së shtatë.....22
5.1.2.Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike
dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së tetë.....25
5.1.3.Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike
dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së nëntë.....27
5.2. KORELACIONET E VARIABLAVE MANIFESTE..... 30
5.2.1. Korelacionet ndërmjet variablave në hapësirën
antropometrike manifeste të nxënësve të klasës së shtatë.....30
5.2.2.Korelacionet e variablave në hapësirën antropometrike dhe
motorike të klasës së tetë 31
5.2.3. Korelacionet ndërmjet variablave në hapësirën

antropometrike manifeste të nxënësve të klasës së nëntë.....32
5.3. Dallimet ndërmjet nxënësve 34
5.3.1 T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës
së shtatë në hapësiren antropometrike dhe motorike 34
5.3.2 T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës
së tetë në hapësiren antropometrike dhe motorike.....36
5.3.3 T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së tetë dhe klasës
së nëntë në hapësiren antropometrike dhe motorike..... .38
6. ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE TË SHTRUARA.40
7.PËRFUNDIMI…….……..…….41
8. SUMMARY……...42
9.LITERATURA ……..……....……..43

1.HYRJE

Sporti i hendbollit hyn në kuadër të sporteve polistrukturale komplekse, është lojë kolektive për nga struktura e lëvizjeve dhe bën pjesë në kuadër të sporteve më të zhvilluar në botë. Loja e hendbollit, me elementet e saja teknike dhe taktike si dhe me lëvizje të shpejta, duele të ashpra, kërcime të larta dhe të ndryshme, gjatë kontaktit me kundërshtarë, e paraqesin ate si një lojë mjaft interesante për publikun.

Nxënësit, nëpërmjet lojës së hendbollit arrijnë të bëjnë transformimin e karakteristikave antropometrike, motorikës bazike dhe motorikës situacionale. Për të pasur rezultate në përzgjedhje dhe për të arritur ate që nxënësit të shprehin dëshirën për të luajtur hendboll, duhet një punë sistematike më nxënës, jo vetëm me orët e përcaktuara sipas planprogramit shkollor por duhet të angazhohemi edhe jashtë orarit mësimor.

Periudha më e volitshme për orientim në lojën e hendbollit është ajo e grup-moshave 12-14 vjeçare (cituar Koca, A. 2009). Dhe në bazë të studimeve të hulumtuara deri më tani ,del se kjo periudhë kohore është e përshtatshme për përvetësimin e teknikave themelore të sportit të hendbollit, prandaj duhet kushtuar rëndësi të madhe për afirmimin e sportit të hendbollit dhe orientimin e nxënësve në këtë sport i cili është një ndër sportet më me perspektivë në vendin tonë.

Duke konsideruar se hendbolli është sport mjaft i popullarizuar në botë, nga loja e tij dinamike,atraktive dhe që adhurohet nga të gjitha moshat dhe gjinitë, duhet kushtuar më shumë rëndësi edhe në shkollë.

Posaçërisht duhet cekur se garat në lojën e hendbollit kanë munguar shumë e sidomos në regjionin e komunës së Drenasit. Kjo dukuri vërehet shumë lehtë në sportin shkollor kosovar, përveç në disa komuna ku është bërë traditë tanimë loja e hendbollit, tek meshkujt e poashtu edhe tek femrat.

Përgatitja fizike, mësimi i elementeve teknike dhe taktike, si elemente bazë për lojën e hendbollit, do të ishte një obligim shtesë i kuadrove të cilët punojnë në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta për të masivizuar lojën e hendbollit.

1.1 HULUMTIMET E DERITANISHME

Për të bërë një hulumtim, çdo herë duhet të bazohemi në hulumtimet e deritanishme të dimensioneve, antropometrike dhe motorike, të cilat kanë të bëjnë me ngjashmëritë e punimit tonë, dhe si shembull kemi marrë autorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë: (Çitaku.F., Koca, A., Nixha, M., Selimi,M., etj.).

Çitaku, F. (1985), në hulumtimin " Struktura latente e precizitetit"(3) ka bërë hulumtime me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 ndryshore të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale latente të strukturës së precizitetit, me ç'rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

Koca, A. (2009) Hulumtimi i tij me temën: "Relacionet dhe ndryshimet në hapësirën antropometrike, funksionale dhe aftësive lëvizore bazike e të lëvizjeve situacionale ndërmjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të Kosovës në hendboll" autori në këtë hulumtim ka vërtetuar relacionet në hapësirën manifeste dhe ka përdorur faktoriale dhe analizën e T-testit.

Rakovica, H. (1998) ,në hulumtimin "Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj"[11], në mostrën prej 300 nxënësve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstraktuar 4 faktorë latentë të hapësirës lëvizore:

1.Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.

2. Faktori i forcës statike dhe përsëritëse të këmbëve.

3. Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.

4. Faktori forcës statike dhe përsëritëse të këmbës.

Gjinolli, E. (1997), në temën " Karakteristikat antropometrike të vlefshme për volejboll te nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore " (4), ka bërë hulumtimin duke pasur qëllim thelbësor antropometrinë dhe motoriken me nxënësit me orientim në volejboll. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike: në analizën regresive në mostrën e variablave predikore janë përfshirë 18 ndryshore antropometrike, kurse në atë motorike 10.

Rakovica, H. (1998) në hulumtimin "Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj"[11], në mostrën prej 300 nxënësve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstraktuar 4 faktorë latent të hapësirës motorike:

1. Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.
2. Faktori i forcës statike dhe përsëritëse i këmbëve.
3. Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.
4. Faktori forcës statike dhe përsëritëse të këmbës.

Çitaku, F. (1981), ka bërë hulumtime në hapësirën motorike në segmente të forcës,shpejtësisë dhe precizitetit. Këto hulumtime i ka realizuar me 118 sportistë aktivë (hendbollist,basketbollist dhe volejbollist) të ligës së Kosovës dhe asaj Federative. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i strukturës faktoriale të variablave të zbatuara, përcaktimi i ndërlidhjeve faktoriale në hapësirën manifeste dhe latente,varësisht nga tri grupet e sportistëve. Në bazë të analizës së të dhënave janë emërtuar katër faktorë të rëndësishëm:

Faktori i parë është definuar si kombinim i forcës repetitive dhe statike ,
faktori i dytë është definuar si forcë eksplozive,
faktori i tretë është emërtuar si kombinim i forcës statike në radhë të parë dhe si forcë repetitive në rend të dytë. Është konstatuar se preciziteti nuk është ekstrahuar si faktor.Variablat e aplikuara të hapësirës bazike motorike nuk diferencojnë sportistët në grupe.

Koca, A. (2004) Në punimin e tij të magjistraturës nga testet e aplikuara dhe metodat e shfrytëzuara, në hulumtimin e bërë, qëllimi ka qenë të vihen në pah ndryshimet ndërmjet katër grupeve në të dy hapësirat si dhe të vërtetohen ndërlidhjet (relacionet) e dimensioneve antropometrike dhe motorike në mes të sportistëve të katër sporteve kolektive (hendbollistëve, basketbollistëve, hendbollisteve dhe volejbollistëve).

Selimi, M. (2001), në punimin e tij ka bërë vlerësimin e parametrave antropometrik dhe motorike të hendbollisteve të Anamoravës (7), me ç'rast ka përdorur analizën faktoriale dhe i janë ekstrahuar tre faktorë latent në hapësirën antropometrike dhe tre faktorë latentë motorik të cilët janë emërtuar si: 1. Faktori longitudinal dhe transversal i skeletit.

2. Faktori i dimensionit cirkular dhe i masës së trupit.

3. Faktori i dimensionit cirkular dhe transversal i gjymtyrë të poshtme.

Ndërsa në hapësirën motorike:

1. Faktori i fleksibilitetit dhe i aftësive të lëvizjeve specifike me topin.

2. Faktori i udhëheqjes së topit në gjysmërreth dhe agjilitetit.

3. Faktori i shpejtësisë së udhëheqjes së topit dhe i forcës eksplozive.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Vlerësimi i karakteristikave antropometrike dhe atyre motorike, e në veçanti të motorikes situacionale, për lojën e hendbollit është shumë e rëndësishme që të përdoren disa qëllime në këtë punim.

Qëllimi i parë në këtë punim ka të bëjë me vlerësimin e rritjes dhe gjatësisë së nxënësve në hapësirën antropometrike për secilën gjeneratë veç e veç, në mënyrë të veçantë si dhe të vërtetohet ndryshimi ndërmjet tyre.

Si qëllim tjetër i këtij punimi është po ashtu me vlerësimin e ndryshimeve të aftësive të motorikes bazike, për secilën gjeneratë veç e veç në mënyrë të veçantë, si dhe të vërtetohet ndryshimi i aftësive të motorikës bazike ndërmjet tyre.

Ndërsa qëllimi tjetër i këtij punimi është shumë me rëndësi që të vërtetohet vlerësimi dhe ndryshimet e aftësive të motorikes situacionale, për secilën gjeneratë veç e veç në mënyrë që të vërtetohet dallimi në aftësivë e motorike situacionale në lojën e hendbollit ndërmjet tyre.

2.1-HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të qëllimit të këtij punimi dhe, për të vërtetuar këtë qëllim i kemi parashtruar këto hipoteza:

H1: Do të paraqiten specifika të vlefshme të rezultateve bazike në hapësirës manifeste antropometrike, motorike dhe të motorikes bazike.

H2: Do të paraqiten korrelacione të vlefshme ndërmjet hapësirës manifeste antropometrike dhe motorike.

H3: Presim të vërtetojmë ndryshimet ndërmjet nxënësve të gjeneratave të ndryshme në hapësirën antropometrike,motorike dhe motorike situacionale.

3. METODAT E PUNËS

3.1 Mënyra e zbatimit të punimit

Për të zbatuar këtë punim, janë marrë si mostër nxënësit meshkuj të klasave të VII, VIII dhe IX të shkollës së mesme të ulëta " Mehmet Gradica" dhe "Rexhep Xheli" të Komunës së Drenasit. Në këtë punim janë përfshirë 60 nxënës.

Për të realizuar matjet antropometrike do të angazhohen disa kolegë të cilët kanë përvojë dhe ato do të bëhen në orët e paradites (Rexhepi, A. 2009; Mišigoj-Duraković, M. 2008). Ndërsa matjet e motorikës bazike dhe atyre situacionale, do të realizohen varësisht nga kur nxënësit kanë orën e rregullt të Edukatës Fizike dhe Sportit, gjithashtu edhe këto matje do të bëhen nga një grup i profesionalizuar për ketë punë.

3.2 Instrumentet matëse të variablave antropometrike

Për të zbatuar qëllimin e këtij punimi, kemi përzgjedhur 5- variabla antropometrike për të cilat mendojmë se e mbulojnë hapësirën e mjaftueshme për këtë punim , për të bërë një vlerësim të nxënësve në hapësirën antropometrike, do të bëjmë vlerësimin e dimensionit longitudinal të skeletit, të volumenit dhe definimin e dimensionit transversal të gjoksit dhe shuplakës së dorës:

1. APESHA - Pesha e trupit

2. ALARTE - Lartësia e trupit

3. AGJKRH - Gjerësia e krahëve të hapur

4. AGJASH - Gjatësia e shuplakës së dorës

5. AGJRSH - Gjerësia e shuplakës së dorës

3.2.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

1. APESHA- Pesha e trupit matët me peshojë decimale lëvizëse, e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg. Peshoja është domosdoshme të vëhët në pozitë horizontale dhe, për çdo ditë para përdorimit dhe mbas 10 matjeve të bazhdarohet. I maturi është i zbathur, në brekë të shkurtër, qëndron në këmbë, i qetë në mes të peshojës. Pasi që treguesi të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi 0.1 kg.

Foto 1

2. ALARTË- Lartësia e trupit matet me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari duhet të jetë i zbathur dhe me brekë të shkurtër, të qëndrojë në këmbë në bazën e fortë horizontale. Koka e të testuarit duhet të jetë në pozitë që, vija e cila e bashkon skajin e sipërm të zgavrës së jashtme të organit të dëgjimit, të jetë në horizontale me skajin e poshtëm të zgavrës së syrit (i ashtuquajturi rrafshi i Frankfurtit). I testuari e drejton shpinën aq sa është e mundur, ndërsa shputat i bashkon.. Matësi qëndron në anën e majtë të të maturit dhe e kontrollon se a është vënë antropometri saktësisht përgjatë anës së prapme dhe vertikalisht, pastaj e zbret krahun tek antropometri që është horizontalisht, derisa ai të prekë kokën e të maturit. Atëherë e lexon rezultatin në shkallën dhe në lartësinë e pjesës së epërme të trekëndëshit, në lartësi rrëshqitëse. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 2

AGJKRH - Gjatësia e krahëve hapur është matur me antropometër që është vendosur në sipërfaqe të rrafshtë (në murë) në pozitë horizontale. Matja është bërë prej gishtit të mesëm(digitus medius) të dorës së majtë,deri te gishti i mesëm i dorës së djathtë. Saktësia e matjes 0.1cm



Foto 3

4. AGJASH- Gjatësia e shuplakës matet me antropometër të shkurtuar milimetrik dhe matet prej gjatësisë së nyjës së dorës deri të skaji i poshtëm i gishtit të mesëm (i gjatë). Antropometri vendoset në fund të gishtit të mesëm pra, në majën e gishtit digitus medius e deri tek vija ndërmjet radiusit dhe ulnës. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 4

5. AGJRSH- Gjerësia e shuplakës matet me antropometër të shkurtuar milimetrik dhe e benë matjen prej gishtit të vogël deri te gishti i madh (tërthorazi).



Foto 5

3.3 Grupi i instrumenteve matëse të variablave të motorikës bazike dhe motorikës situacionale

Për të realizuar këtë punim i cili ka për qëllim të ketë vlerësim real të aftësive motorike të nxënësve, ne i kemi përzgjedhur këto teste të motorikës bazike (Çitaku, F. 1981; Nixha,M. 1985):

1. **MKLV** - Kërcimi së larti nga vendi
2. **MKGJV** - Kërcimi së gjati nga vendi.
3. **MVR 40m** - Vrapimi në 40 metra, starti i lartë

Testet e motorikës situacionale janë përzgjedhur në mënyrë që nxënësit të shprehin aftësitë e tyre profesionale për lojën e hendbollit, ku edheështë qëllimi kryesorë në mënyrë që të kemi mundësi të përzgjedhjes së tyre për sportin e hendbollit, ata do të testohen në 3 teste të motorikes situacionale:

1. **MSHUTOP** -Shpejtësia e udhëheqjes së topit 40 m.
2. **MSHVTOP**- Shpejtësia vepruese me top cik-cak 9 m.
3. **MSATOP** -Saktësia e goditjes se shenjës 7 m.

3.3.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike bazike dhe situacionale

1. **MKLV**- Kërcim nga vendi në lartësi.

I testuari është i kthyer brinjazi prej shiritit centimetrik, së pari e ngritë krahun e shtrirë lart në të gjitha nyjet. Matet lartësia nga dyshemeja deri të gishti i mesëm, që shënohet me centimetra. I testuari nga qëndrimi vertikal i kthyer nga shiriti centimetrik i improvizuar, që i është lejuar lëvizja e krahut, kërcen dhe e prek shiritin me njërën dorë, varësisht nga është kthyer, në anën e majtë apo të djathtë. Pas matjes së lartësisë, pa kërcim në shtrirjen e krahut dhe pas kërcimit nga vendi, e gjejmë lartësinë e shkëputjes nga vendi. Prej tre tentimesh shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.

Foto 6

2. MKGJV - Kërcim së gjati nga vendi. Shkëputja kryhet nga vendi me të dyja këmbët. U lejohen lëvizjet e hovit me duar, ndërsa këmbët vendosen mbrapa vijës së kërcimit. Kërcimi bëhet me forcë maksimale, duke kërcyer me këmbë të bashkuara. Kërcimi bëhet mbi dyshek, sa më gjatë që të jetë e mundur. Gjatësia e kërcimit matet me centimetra pra, distanca në mes të vijës së nisjes dhe shenjës më të afërt të thembrës në dyshek. Prej tri tentimesh, shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.

3. MVR 40m - Vrapim 40 metra, starti i lartë. Vrapimi kryhet në shtegun e gjatë prej 40 metrash nga vija e nisjes e deri tek vija e cakut.

Gjerësia e shtegut është 1.20m. I testuari nga pozita e nisjes së lartë, pas komandës "gati" dhe sinjalit për nisje, vrapon me shpejtësi maksimale në distancën prej 40m. Koha matet nga momenti i sinjalit për nisje e derisa vrapuesi të kalojë me gjoks rrafshin vërtikal mbi vijën e cakut. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sec.

Foto 7

4. **MSHUTOP -** Shpejtësia e udhëheqjes se topit. Vija e startit është te vija ku takohet ajo e 6 metërshit me ate fundore. I testuari ka për detyrë që nga vija e nisjes të vrapoj sa më shpejt që është e mundur duke udhëhequr me top kah vija tjetër e 6 metërshit . Ky test përsëritet dy herë pa ndërprerë, pasi që këtu testohet **:** shpejtësia vepruese me top, niveli teknik i zbatimit të udhëheqjes dhe qëndrueshmëria situacionale. Në fillim lojtarit i matet pulsi në qetësi dhe pas ngarkesës.

Foto 8

5. **MSHVTOP- Shpejtësia** vepruese me top. Nga vija fundore tërheqim një vijë prej 2m në drejtim të 9m, ku prehet kjo vijë të 9m dhe vendosim një kon nga plastika, të njëjtën gjë e bëjmë edhe në anën tjetër të fushës, brenda këtyre dy konave të plastikes vendosim edhe kona të tjera me distanca të njëjta njëra me tjetrën, përreth vijës së 9m dhe 6m. Nisja është nga vija fundore në mes 6-9m në anën e majtë të fushës. Subjekti duhet të bëjë lëvizje zik-zake në mes 6-9 në drejtim të konave të plastikes nga e para deri tek ajo e fundit.

Foto 9

6. **MSATOP -** Gjuajtje nga 7 meteërshi. I testuari vendoset afër vijës së 7 metërshit, i kthyer ne pozitë të drejtë me portën. Para vetes ka 5 topa dhe është në dijeni se duhet të gjuhen 5 gjuajtje. Pasi ndihmësi i jep topin në dorë, i testuari është i obliguar që të bëj lëvizje nga vendi për 180 shkallë dhe të gjuaj në portë, ku në këndin e djathtë të sipërm të portës është e vendosur një tabllo me dimensione 50x50 cm, i testuari ka për të gjuajtur në cak (tabllo). Në fletëtestim shënohen vetëm goditjet në cak.

Foto 10

4. Metodat dhe përpunimi i rezultateve

Me qëllim të interpretimit të mundshëm të rezultateve, ato do të përpunohen me programin e pakos SPSS, version 20.0 për windows, e cila na e mundëson që nëpërmjet këtyre metodave të aplikuara, të vërtetojmë qëllimin e këtij punimi master. . Përpunimi i rezultateve do te bëhet me këto metoda statistikore:

- Në hapësirën antropometrike, motorikës bazike dhe të motorikës situacionale, do të llogariten nëpërmjet analizës deskriptive:

1. Rangimi i rezultateve minimale dhe maksimale
2. Mesatarja aritmetikore.
3. Devijimet standarde.
4. Rezultati max-min.
5. Masat e asimetrisë skew-kurt.

- Relacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike dhe motorikës situacionale.

Analizës T-test e cila na e mundëson të vërtetojmë dallimet ndërmjet nxënësve.

5. REZULTATET DHE DISKUTIMET

5.1. Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve.

5.1.1. Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së shtatë

Në këtë studim janë marrë pesë variabla të hapësirës antropometrike, dhe mendohet se ky sistem i variablave e plotëson kriterin për një hulumtim të natyrës së studimit master.

Në tabelën 1. janë paraqitur rezultatet e analizës deskriptive statistikore të nxënësve të klasës së shtatë, tek të cilët, testet antropometrike i kemi realizuar gjatë kohës së orës së edukatës fizike dhe sportit, e poashtu edhe testet motorike i kemi organizuar gjatë orëve të rregullta të lëndës së Edukatës Fizike dhe Sportit

Në tabelën 1 janë dhënë rezultatet statistikore deskriptive{përshkruese}, ku janë shënuar në këtë mënyrë: rezultati minimal (min.), maksimal (max.) mesatarja aritmetikore (mean.) , devijimi standard (std. Dev.), masat e asimetrisë (Skew dhe kurt.) dhe (N) numri i lojtareve.

Duke e analizuar matricën e paraqitur nga rezultatet e fituara në tabelën nr. 1. ndërmjet rezultatit minimal dhe maksimal, të reflektuara nga devijimi standard, vlerat e peshës tregojnë për një devijim të lartë (11.19) të cilat e vërtetojnë edhe masat e asimetrisë Skevnews dhe Kurtosis (2.083- 5.338) që tregojnë se ky grup nuk është homogjen. Këto rezultate janë manifestuar edhe te variablat e tjera si ALARTE, AGJKRH, ku vërehet një devijim më i lartë sesa ai standard, ndërsa rezultate më të mira dhe në suaza të normales, i kemi tek grupi i nxënësve në variablat AGJASHE dhe AGJSHR. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e masave të asimetrisë të cilat tregojnë një shpërndarje të mirë të rezultateve të paraqitura në këtë tabelë .

Tabela 1.Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike të klasës së shtatë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
APESHA	20	35	83	46,6	11,19	2,083	5,338
ALARTE	20	130,06	173,01	157,58	9,74	-0,979	2,099
AGJKRH	20	127,07	178,03	158,95	11,82	-0,763	1,405
AGJASHE	20	15	19	16,95	1,22	-0,159	-0,794
AGJRSH	20	16,5	22	18,68	1,44	0,605	0,029

Në tabelën nr. 2. janë paraqitur rezultatet e analizës statistikore deskriptive të nxënësve të klasës së shtatë të cilat gjatë kohës së matjeve antropometrike dhe testeve motorike janë realizuar gjatë orëve të rregullta të Edukatës Fizike dhe Sportit sipas orarit mësimorë

Në këtë hulumtim janë aplikuar gjashtë ndryshore motorike të motorikes bazike dhe testeve situacionale të lojës së hendbollit, ku mendohet se ky grup variablave motorike bazike dhe atyre situacionale e mbulojnë mjaftueshëm punën në këtë studim të master.

Në këtë tabelë janë paraqitur rezultatet e analizës deskriptive statisikore: numri i lojtareve (N),rezultati minimal (min), maksimal (max.) mesatarja aritmetikore (mean) , devijimi standard (std. dev), masat e asimetrisë (Skew dhe kurt).

Tabela 2.Treguesit themelor statistikor në hapësirën motorike të klasës së shtatë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
MKLV	20	22	39	28,85	4,35	0,597	0,024
MKGJV	20	140,09	195,04	168,55	17,18	-0,008	-1,209
MVR40m	20	6,65	8,68	7,62	0,55	0,155	-0,313
MSHUTOP	20	9,66	13,24	11,56	0,79	-0,202	0,896
MSHVTOP	20	10,05	16,65	13,51	1,87	0,255	-0,945
MSATOP	20	0,00	4	2,05	1,23	0,083	-0,8

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë për të arriturat e nxënësve në hapësirën e motorikës bazike dhe asaj situacionale dhe nëpërmjet analizës deskriptive të statistikës themelore, mund të vërejmë se rezultatet në raport me hapësirën antropometrike, janë më homogjene vetëm tek testi i forcës eksplozive kërcim se gjati , nga vendi ku kemi një dallim më të madh dhe është paraqitur vlera më e lartë e devijimit standard (17.18) ku dallojnë vlerat ndërmjet minimalës me (140.09)cm dhe asaj maksimales me (195.04)cm.

Ndërsa vlerat tjera, nxënësit i kanë paraqitur pothuajse të përafërta, e që mund të themi se, në hapësirën motorike ka një shtrirje simetrike të rezultateve në Skewness edhe kurtosis, të cilat vërtetojnë për një grup përafërsisht të njëjtë.

5.1.2. Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së tetë

Duke e analizuar matricën e paraqitur nga rezultatet e fituara në tabelën 3, ndërmjet rezultatit minimal dhe atij maksimal , të reflektuar nga devijimi standard edhe tek nxënësit e klasës së tetë, vlerat e peshës tregojnë për një devijim të lartë (18.28) të cilat i vërtetojnë edhe masat e asimetrisë skewnews dhe Kurtosis (1.662-2.539) që tregojnë se ky grup nuk është homogjen tek rezultatet e peshës.

Tabela 3. Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike të klasës së tetë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
APESHA	20	36,00	105,00	56,00	18,28	1,662	2,539
ALARTE	20	153,06	183,01	165,42	7,83	,175	-,197
AGJKRH	20	150,03	191,01	167,17	10,41	,332	-,212
AGJASHE	20	15,50	21,00	17,95	1,05	,714	4,008
AGJRSH	20	16,50	23,00	20,22	1,79	,008	-,515

Të njëjtat rezultate janë paraqitur edhe tek variablat e tjera si ALARTE, AGJKRH ku vërehet një devijim më i lartë sesa ai standard, ndërsa rezultate më të mira dhe në suaza të normales sepse i kemi variablat AGJASHE dhe AGJSHR janë tek grupi i nxënësve. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e masave të asimetrisë të cilat tregojnë një shpërndarje të mirë të rezultateve të paraqitura në këtë tabelë.

Rezultatet e paraqitura në tabelën 4 tregojnë për aftësitë e nxënësve në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj situacionale. Nëpërmjet analizës deskriptive të statistikës, mund të vërejmë se, rezultatet nxënësve të klasës së tetë, në raport me hapësirën antropometrike janë më homogjene por, dallimi është paraqitur tek testi i forcës eksplozive kërcim se gjati nga vendi sikurse edhe tek nxënësit e klasës së shtatë, ku mund të vërejmë një dallim më të madhe ku edhe është paraqitur vlera më e lartë e devijimit

standard (21.51), dhe se këto vlera dallojnë ndërmjet minimales me (120.05)cm dhe maksimales me (210.10) cm. Dallimi është i theksuar edhe tek testi i kërcimit së larti me devijim prej (7.79), dhe rezultati minimal (23.00) ndërsa maksimal 56.00). Vlerat e tjera të analizës deskriptive tek nxënësit e klasës së tetë, janë paraqitur pothuajse të përafërta, e që mund të themi se në hapësirën motorike ka një shtrirje simetrike të rezulateteve në Skewness edhe kurtosis.

Tabela 4. Treguesit themelor statistikor në hapësirën motorike të klasës së tetë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
MKLV	20	23,00	56,00	35,25	7,79	,878	1,248
MKGJV	20	120,05	210,10	175,07	21,51	-,773	1,074
MVR40m	20	5,54	8,43	7,06	,71	-,103	,018
MSHUTOP	20	7,76	11,64	10,10	,96	-,710	,491
MSHVTOP	20	10,65	13,40	12,12	,83	-,176	-,915
MSATOP	20	0,00	3,00	1,70	,97	-,067	-,964

5.1.3 Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të klasës së nëntë

Në tabelën 5 janë dhënë rezultatet statisikore deskriptive të nxënësve të klasës së nëntë, rezultatet janë shenuar në këtë mënyrë: rezultati minimal (min), maksimal (max) mesatarja aritmetikore (mean) , devijimi standard (std. dev), masat e asimetrisë (Skew dhe kurt) dhe (N) numri i lojtarve.

Tabela 5. Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike të klasës së nëntë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
APESHA	20	35,00	76,00	52,20	9,18	,590	1,388
ALARTE	20	145,01	179,05	163,95	8,16	-,524	,474
AGJKRH	20	147,10	180,01	164,60	8,65	-,448	-,019
AGJASHE	20	15,50	20,00	17,62	1,54	,190	-1,175
AGJRSH	20	17,00	22,00	19,70	1,60	,075	-1,248

Duke e analizuar tabelën 5 të tregueseve themelor statistikor, ndërmjet rezultatit minimal dhe maksimal të reflektuara nga devijimi standard, vlerat e peshës tregojnë për një devijim të lartë (9.18), të cilat e vërtetojnë edhe rezultatet minimale (35.00) , ndërsa ai maksimal (76.00), që tregojnë një dallim të lartë ndërmjet këtyre dy rezultateve. Rezultatet përafërsisht të njëjta janë manifestuar edhe tek variablat e tjera si, ALARTE, AGJKRH , ku vërehet një devijim më i lehtë sesa ai standard, ndërsa rezultate më të mira dhe në suaza të normales, kemi tek variablat AGJASHE dhe AGJRSH. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet te masave të asimetrisë të cilat tregojnë një shpërndarje të mirë të rezultateve të paraqitura në këtë tabelë.

Rezultatet e paraqitura në tabelën 6 tregojnë për performancën e nxënësve në hapësirën e motorikës bazike dhe asaj situacionale dhe nëpërmjet analizës deskriptive të statistikës, mund të vërejmë edhe këtu se, dallimi ndërmjet rezultatit minimal dhe maksimal ,bëhet vetëm tek testi i forcës eksplozive, kërcim se gjati nga vendi ku kemi një dallim më të madh me vlerë të e lartë e devijimit standard (18.38), ndërsa vlerat ndërmjet minimales me (140.03) cm dhe maksimales me (210.03)cm. Ndërsa vlerat e tjera nxënësit i janë paraqitur pothuajse të përafërta që mund të themi se në hapësirën motorike ka një shtrirje simetrike të rezultateve në Skewness edhe kurtosis të cilat vërtetojnë për një grup përafërsisht të njëjtë.

Tabela 6. Treguesit themelor statistikor në hapësirën motorike të klasës së nëntë

Variablat	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
MKLV	20	20,00	46,00	32,20	7,14	,483	-,326
MKGJV	20	140,03	210,03	170,83	18,38	,014	-,132
MVR40m	20	6,22	8,55	7,00	,64	,655	-,035
MSHUTOP	20	8,39	12,91	10,20	1,31	,372	-,636
MSHVTOP	20	10,57	13,90	12,31	0,90	,072	-,691
MSATOP	20	0,00	4,00	1,85	1,18	,319	-,697

5.2. KORELACIONET E VARIABLAVE MANIFESTE

5.2.1. Korelacionet ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve të klasës së shtatë.

Në tabelën 7 janë paraqitur rezultatet e korelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike dhe variablave në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj situacionale të nxënësve të klasës së shtatë.

Tabela 7 Amëza e korelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike tek nxënësit e klasës së shtatë

Variablat	APESHA	ALARTE	AGJKRH	AGJASHE	AGJRSH
MKLV	-,103	,165*	,074	-,076	-,066
MKGJV	-,018	,350**	,309**	,020	-,034
MVR40m	-,060	-,206*	-,221*	-,114*	-,040
MSHUTOP	-,258*	-,243*	-,147*	-,076	-,050
MSHVTOP	-,165*	-,233*	-,150*	,083	,106
MSATOP	,158*	-,103	-,083	,211*	,190*

*. Correlation is significant at the 0.05 level (1-tailed)
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Duke analizuar rezultatet, mund të vërejmë se në amëzën e korelacioneve të variablave, ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorikës bazike dhe asaj situacionale, janë fituar rezultate mesatare me vlera korelative. Vlera më të larta korelative ndërmjet këtyre dy hapësirave, kanë dhënë variablat e forcës eksplozive MKGJV, me lartësinë e trupit ALARTE dhe gjatësinë e krahëve.

AGJAKRH në vlera 0.350** dhe 0.309**, MSHUTOP , ka treguar një korelacion negativ me APESHA dhe ALARTE në vlerë prej -.258* dhe -.243*. Ndërsa nga hapësira antropometrike më së shumti lidhje korelative me testet motorike ka pasur Lartësia e trupit me të gjitha variablat motorike në vlerë prej -.103* deri 0.350**. Mund të theksojm se edhe gjatësia e krahëve hapur ka pasur një korelacion me disa nga variablat motorike.

5.2.2. Korrelacionet ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve të klasës së tetë

Në tabelën 8 janë paraqitur rezultatet e korelacioneve ndërmjet variablave në hapësiren antropometrike dhe variablave në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj situacionale të nxënësve të klasës së tetë.

Rezultatet e paraqitura në amëzën e korelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike të klasës së tetë, mund të vërejmë se janë fituar rezultate mesatare me vlera korelative ndërmjet variablave. Vlera më të larta korelative ndërmjet këtyre dy hapësirave kanë dhënë variabla e forcës eksplozive MKLV me Lartësinë e trupit ALARTE në vlera 0.320**, gjatësinë e krahëve AGJAKRH 0.429**, me AGJASHE 0.304** dhe me AGJRSH në vlerë prej 0.329**, kurse vlera më të vogla ka pasur me APESHA -0.111. Ndërsa variabla tjetër që ka treguar korelacione të larta, por negative, është MSHUTOP me APESHA 0.104*, ALARTE në vlerë prej -.241* me AGJKRH --.384*, me AGJSHE -.381**, dhe më së shumti me AGJRSH në vlerë prej -.401**. Ndërsa nga hapësira antropometrike më së shumti lidhje korelative me testet motorike ka pasur Pesha e trupit me të gjitha variablat motorike, përveç me MSHVTOP në vlerë prej -.104* deri 0.440**.

Tabela 8 Amëza e korelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike tek nxënësit e klasës së tetë

	APESHA	ALARTE	AGJKRH	AGJASHE	AGJRSH
MKLV	-,111*	,320**	,429**	,304**	,329**
MKGJV	-,440**	-,008	,127*	,036	-,077
MVR40m	,282*	,022	-,147	,005	,059
MSHUTOP	-,104*	-,241*	-,384**	-,381**	-,401**
MSHVTOP	-,010	-,156*	-,310**	-,363**	-,270*
MSATOP	,156*	,030	-,002	,189*	,280*

*. Correlation is significant at the 0.05 level (1-tailed).
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

5.2.3 Korelacionet ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve të klasës së nëntë

Në tabelën 9 janë paraqitur rezultatet e korelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike dhe variablave në hapësiren e motorikes bazike dhe asaj situacionale të nxënësve të klasës së nëntë.

Duke analizuar rezultatet e paraqitura në tabelën 9, mund të vërejmë se korrelacionet ndërmjet variablave të hapësirës antropometrike me ato të hapësirës motorike bazike dhe asaj situacionale, janë fituar disa rezultate të larta dhe rezultate mesatare me vlera korelative. Vlera më të larta korelative ndërmjet

këtyre dy hapësirave kanë dhënë variabla e forcës eksplozive kërcim së gjati me lartësinë e trupit në vlerë 0.713** , me gjatësinë e krahëve në vlerë prej 0.744**, me peshën e trupi në vlerë prej 0.438**. Edhe variabla tjetër motorike e udhëheqjes së topit ka treguar një korelacion negativ me të gjitha variablat antropometrike në vlerë prej -.292* dhe -.543*. Ndërsa nga hapësira antropometrike, më së shumti lidhje korelative me testet motorike ka pasur Lartësia e trupit me të gjitha variablat motorike në vlerë prej -.128* deri 0.713**, dhe gjatësia e krahëve hapur me të gjitha testet motorike në vlerë prej -0.330* deri në 0.744**.

Tabela 9. Amëza e korelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike tek nxënësit e klasës së tetë

	APESHA	ALARTE	AGJKRH	AGJASHE	AGJRSH
MKLV	-,059	,429**	,421**	,117*	,049
MKGJV	,438**	,713**	,744**	,248*	,104
MVR40m	-,265*	-,128*	-,330**	-,226*	,066
MSHUTOP	-,292*	-,543**	-,529**	-,317**	-,302**
MSHVTOP	-,241	-,576*	-,383*	-,438*	-,173*
MSATOP	-,147*	-,160*	,046	,385**	,558**

* Correlation is significant at the 0.05 level (1-tailed).
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

5.3 DALLIMET NDËRMJET NXËNËSVE

5.3.1 T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës së tetë në hapësirën antropometrike dhe motorike

Për të vërtetuar dallimet ndërmjet nxënësve te klasave të shtata me nxënësit e klasave të teta dhe të nënta, është përdorur metoda e T- Testit me anë të së cilës bëhet vërtetimi i ndryshimeve statistikore në mes të dy grupeve në hapësirën antropometrike, motorike dhe të motorikes situacionale për secilën variabël veç e veç. Me këtë metodë do të arrijmë të vërtetojmë ndryshimet se sa herë është më i madh ndryshimi i dy mesatareve aritmetikore. Për të treguar vlerëshmërinë statistikore me anën e këtij testi, duhet ditur vlerën e T-Testit, e cila për këtë mostër është $T > 1.96$, në nivelin e rëndësisë statistikore $p< 0.05$. Duke analizuar tabelën 10, ku janë paraqitur rezultatet e klasës së shtatë dhe klasës së tetë, mund të themi se ndryshimi në mes të këtyre dy grupeve është statistikisht i vlerëshëm në tetë nga gjithsej 11 variabla të hapësirës antropometrike dhe motorike. Në tabelën 10, mund të shohim dallimet për secilën variabël veç e veç dhe mund të konstatojmë se, ndryshime të rëndësishme statistikore në hapësirën antropometrike, janë paraqitur në lartësinë e trupit në vlerë 0.008, gjatësinë e krahëve hapur 0.025, gjatësinë e shuplakës së dorës 0.009 dhe në gjerësinë e shuplakës se dorës ne vlerë 0.005. Ndërsa në hapësirën motorike dallimet në favor të së tetës janë në variablen e kërcimit së larti në vlerë prej 0.003, Vrapim në 40 metra 0.010, udhëheqja e topit 0.000 dhe shpejtësia e veprimit me top në vlerë prej 0.006.

Tabela 10. T- Testi i ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës së tetë në hapësirën antropometrike dhe motorike

Variablat		N	Mean	Std. Dev.	Sig.
APESHA	Klasa 7	20	46,60	11,19	,059
	Klasa 8	20	56,00	18,27	
ALARTE	Klasa 7	20	157,58	9,74	**,008**
	Klasa 8	20	165,42	7,83	
AGJKRH	Klasa 7	20	158,95	11,82	**,025**
	Klasa 8	20	167,17	10,41	
AGJASHE	Klasa 7	20	16,95	1,22	**,009**
	Klasa 8	20	17,95	1,05	
AGJRSH	Klasa 7	20	18,68	1,44	**,005**
	Klasa 8	20	20,22	1,79	
MKLV	Klasa 7	20	28,85	4,35	**,003**
	Klasa 8	20	35,25	7,79	
MKGJV	Klasa 7	20	168,54	17,18	,296
	Klasa 8	20	175,07	21,51	
MVR40m	Klasa 7	20	7,61	,55	**,010**
	Klasa 8	20	7,06	,71	
MSHUTOP	Klasa 7	20	11,55	,79	**,000**
	Klasa 8	20	10,10	,96	
MSHVTOP	Klasa 7	20	13,51	1,87	**,006**
	Klasa 8	20	12,12	,83	
MSATOP	Klasa 7	20	2,05	1,23	,327
	Klasa 8	20	1,70	,97	

5.3.2 T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës së nëntë në hapësirën antropometrike dhe motorike

Në tabelën 11 janë paraqitur rezultatet e klasës së shtatë dhe klasës së nëntë, duke analizuar rezultatet nxënësit e klasës së shtatë me nxënësit e klasës së nëntë, mund të themi se ndryshimi në mes të këtyre dy grupeve është statistikisht i vlefshëm në pesë nga gjithsej 11 variabla të hapësirës antropometrike dhe motorike. Në tabelën 11, mund të shohim dallimet për secilën variabël veç e veç, dhe mund të konstatojmë se ndryshime të rëndësishme statistikore në hapësirën antropometrike janë paraqitur në lartësinë e trupit në vlerë 0.031 dhe në variablën e gjerësisë së shuplakës së dorës në vlerë prej 0.41. Ndërsa në hapësirën motorike dallimet në favor të nxënësve të klasës së nëntë janë paraqitur në variablen e vrapimit në 40 metra 0.003, udhëheqja e topit 0.000 dhe shpejtësia e veprimit me top në vlerë prej 0.027.

Tabela 11. T- Testi ndërmjet nxënësve të klasës së shtatë dhe klasës së nëntë në hapësirën antropometrike dhe motorike

Variablat		N	Mean	Std. Dev.	Sig.
APESHA	Klasa 7	20	46,60	11,19	,092
	Klasa 9	20	52,20	9,18	
ALARTE	Klasa 7	20	157,58	9,74	**,031**
	Klasa 9	20	163,95	8,16	
AGJKRH	Klasa 7	20	158,95	11,82	,094
	Klasa 9	20	164,60	8,65	
AGJASHE	Klasa 7	20	16,95	1,22	,135
	Klasa 9	20	17,62	1,54	
AGJRSH	Klasa 7	20	18,68	1,44	**,041**
	Klasa 9	20	19,70	1,60	
MKLV	Klasa 7	20	28,85	4,35	,083
	Klasa 9	20	32,20	7,14	
MKGJV	Klasa 7	20	168,54	17,18	,686
	Klasa 9	20	170,83	18,38	
MVR40m	Klasa 7	20	7,61	,55	**,003**
	Klasa 9	20	7,00	,64	
MSHUTOP	Klasa 7	20	11,55	,79	**,000**
	Klasa 9	20	10,20	1,31	
MSHVTOP	Klasa 7	20	13,51	1,87	**,014**
	Klasa 9	20	12,31	,90	
MSATOP	Klasa 7	20	2,05	1,23	,604
	Klasa 9	20	1,85	1,18	

5.3.3. T – Testi ndërmjet nxënësve të klasës së tetë dhe klasës së nëntë në hapësirën antropometrike dhe motorike

Në tabelën 12 janë paraqitur rezultatet e t-testit ndërmjet variablave të nxënësve të klasës së tetë dhe klasës së nëntë, duke analizuar rezultatet nxënësve të klasës së tetë me nxënësit e klasës së nëntë, mund të themi se ndryshimi në mes të këtyre dy grupeve nuk është statistikisht i vlerëshëm nga gjithsej 11 variabla të hapësirës antropometrike dhe motorike. Në tabelën 12, mund të shohim se rezultatet janë të përafërta dhe dallimet për secilën variabël veç e veç, nuk kanë rezultuar me ndryshime të rëndësishme statistikore si në hapësirën antropometrike po ashtu edhe në atë të motorikës bazike dhe situacionale.

Tabela 12. T- Testi i ndërmjet nxënësve të klasës së tetë dhe klasës së nëntë në hapësiren antropometrike dhe motorike

Variabla		N	Mean	Std. Dev.	Sig.
APESHA	Klasa 8	20	56,00	18,27	,413
	Klasa 9	20	52,20	9,18	
ALARTE	Klasa 8	20	165,42	7,83	,565
	Klasa 9	20	163,95	8,16	
AGJKRH	Klasa 8	20	167,17	10,41	,400
	Klasa 9	20	164,60	8,65	
AGJASHE	Klasa 8	20	17,95	1,05	,442
	Klasa 9	20	17,62	1,54	
AGJRSH	Klasa 8	20	20,22	1,79	,336
	Klasa 9	20	19,70	1,60	
MKLV	Klasa 8	20	35,25	7,79	,205
	Klasa 9	20	32,20	7,14	
MKGJV	Klasa 8	20	175,07	21,51	,507
	Klasa 9	20	170,83	18,38	
MVR40m	Klasa 8	20	7,06	,71	,774
	Klasa 9	20	7,00	,64	
MSHUTOP	Klasa 8	20	10,10	,96	,783
	Klasa 9	20	10,20	1,31	
MSHVTOP	Klasa 8	20	12,12	,83	,499
	Klasa 9	20	12,31	,90	
MSATOP	Klasa 8	20	1,70	,97	,665
	Klasa 9	20	1,85	1,18	

6. ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE TË SHTRUARA

Duke u bazuar në qëllimin e këtij punimi dhe për të vërtetuar këtë qëllim kemi vërtetuar këto hipoteza:

H1- Në bazë të hipotezave të parashtruara se do të paraqiten specifikimet të vlefshme të rezultateve bazike në hapësirën manifeste antropometrike, motorike dhe të motorikes bazike, ka rezultuar me vërtetimin se ka pasur rezultatet specifike të nxënësve të klasave të shtata, teta dhe të nënta.

H2- Gjithashtu është plotësuar pjesërisht hipoteza e dytë, e cila është shtruar se do të paraqiten korrelacione të vlefshme ndërmjet hapësirës manifeste antropometrike dhe motorike, me këtë rast ka pasur korrelacione të nivelit mesatar ndërmjet hapësirave.

H3- Me anë të T-testit kemi vërtetuar ndryshime në hapësirat motorike dhe antropometrike ndërmjet grupeve në 11 variabla, në hipotezën e shtruar se të vërtetojmë ndryshimet ndërmjet nxënësve të gjeneratave të ndryshme në hapësirën antropometrike,motorike dhe motorike situacionale , me çka u vërtetua pjesërisht kjo hipotezë. Dallimet më të mëdha janë paraqitur ndërmjet klasës së shtatë dhe të tetë si në hapësirën antropometrike edhe në hapësirën motorike.

7. PËRFUNDIMI

Qëllimi i këtij punimi që parashtruam më lartë, për të vlerësuar parametrat antropometrik motorikë dhe të motorikës situacionale të nxënësve të klasave të shtata, teta dhe të nënta veç e veç, punim i cili do të shërbejë si vlerë e shtuar tek kjo kategori e nxënësve për lojën e hendbollit. Ndërsa do të ketë më së shumti vlera praktike sepse rezultatet e këtij punimi do të vlerësojnë nivelin e lojën se hendbollit në shkollën e mesme të ulët në komunën e Drenasit dhe do të jetë një model për trajnerët apo ekspertët e fushës së sportit të Hendbollit, për të përzgjedhur talentet dhe për të masivizuar këtë sport i cili është mjaft i afirmuar në Kosovë.

Gjithashtu ky punim do të shërbej si pasqyrë reale e punës së arsimtarëve të Edukatës Fizike dhe Sportit, gjatë mbajtjes së procesit mësimor dhe njohjes së nxënësve me sportin e Hendbollit.

Duke u bazuar në mënyrën e zbatimit të këtij punimi dhe qëllimit të parashtruar për këtë punim, për të vlerësuar strukturën antropometrike të nxënësve të komunës së Drenasit dhe realizimin e elementeve të motorikes bazike dhe atyre situacionale.

Ky punim do të jetë në funksion të përzgjedhjes së nxënësve për lojën e hendbollit dhe elementeve tekniko-situacionale, në mënyrë që loja e hendbollit të avancohet dhe të aplikohet në nivel të shkollave dhe sportit shkollorë. Kjo do të mund të arrihet pasi të bëhet vlerësimi adekuat i parametrave antropometrik, motorik dhe të motorikës situacionale të lojës së hendbollit.

8. REZYME

Në këtë punim janë vlerësuar parametrat antropometrik motorikë dhe të motorikës situacionale të nxënësve të klasave të shtata, teta dhe të nënta veç e veç, si dhe është bërë dallimi ndërmjet tyre.

Mostra e këtij punimi kanë qenë 60 nxënës të klasave shtatë, tetë dhe nëntë nga dy shkolla të mesme të ulëta " Mehmet Gradica" dhe "Rexhep Xheli" të Komunës së Drenasit.

Vlera praktike e këtij punimi është sepse rezultatet e fituara në këtë punim do të vlerësojnë nivelin e lojën se hendbollit në shkollën e mesme të ulët në komunën e Drenasit; ky punim do të jetë model për trajnerët apo ekspertët e fushës së sportit të Hendbollit, për të përzgjedhur talentet dhe për të masivizuar këtë sport i cili është mjaftë i afirmuar në Kosovë.

Duke u bazuar në mënyrën e zbatimit të këtij punimi dhe qëllimit të parashtruar për këtë punim, për të vlerësuar strukturën antropometrike të nxënësve të komunës së Drenasit dhe realizimin e elementeve të motorikes bazike dhe atyre situacionale.

Ky punim do të jetë në funksion të përzgjedhjes së nxënësve për lojën e hendbollit dhe elementeve tekniko-situacionale, në mënyrë që loja e hendbollit të avancohet dhe të aplikohet në nivel të shkollave dhe sportit shkollor. Kjo do mund të arrihet pasi që të bëhet vlerësimi adekuat i parametrave antropometrik, motorik dhe të motorikës situacionale të lojës së hendbollit.

SUMMARY

In this paper, anthropometric motoric and situational motoric parameters of the seven, eight, and ninth grade students have been evaluated separately, as well as the difference between them. The sample of this study was sixty students of seventh, eighth, and ninth grades of two middle schools of the Municipality of Drenas, “Mehmet Gradica” and “Rexhep Xheli”.

The practical value of this study is because the obtained results will evaluate the level of handball in the middle schools in the Municipality of Drenas, and it will serve as a model for handball coaches or experts in order to select talented players and to increase this sport which is quite known in Kosovo.

Based on the way of the implementation of this study and the submitted purpose for this study to assess anthropometric structure of the students of Drenas and the execution of the basic and situational motoric elements, this research will be a function of student selection for handball and the technical-situational elements in order to upgrade handball and to implement it in a school level and the sport taught in schools. This could be achieved after the anthropometric motoric and the situational motoric parameters of handball would be assessed.

9. L I T E R A T U R A

11-13 vjeç. Punim magjistrature, UP FKFS, Prishtinë. 1. Çitaku,F.(1981).Hulumtim në hapësirën motorike në segment të forcës, të shpejtësisë dhe të precizitetit, i ka realizuar me 118-sportistë aktiv (hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe të asaj federative*.Elan, Prishtinë.

2.Koca, A. (2009) Relacionet dhe ndryshimet në hapësiren antropometrike funksionale dhe aftësive levizore bazike e të levizjeve situacionale ndermjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të kosovës në hendboll. Disertacion doktorature, Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.

3.Nixha,M. (1985), Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të niveleve të ndryshme të garave dhe analiza komparative me hendbollsitë dhe volejbollistë.

4.Mišigoj-Duraković, M. (2008). Kinantropologija, Biološki aspekti vježbanja. Kineziološki Fakultet Sveućilište Zagreb, Croatia.

5.Rexhepi, A. (2009). Mjekësia Sportive. Ministria e Shëndetësisë. Qendra e Mjekësisë Sportive dhe Rekreacionit.Kolegji EUS Eurosporti, Prishtinë, Kosovë.

6.Selimi, M. (2001). Punim Magjistrature Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.

7.Vuleta,D., Milanovic,D., Gruic,I., & Jukic,I., (2006)“ Mjerenje, vrednovanje o prezentaciji kondicijske pripremljenosti u rukometu.

Rakovica,H.(1997). “ Relacionet në mes të rezultatit kërcim së larti dhe dimensioneve morfologjike dhe motorike”. Disertacion doktorature, Prishtinë.

Rushiti,H.(1999).”Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në zhvillimin e disa karakteristikave psikosomatike te nxënësit ”Acta kineziologika” Prishtinë.

Aliu, M, (1997). Biomotorika , Tekst universitar. Universiteti i Prishtinës FKF, Prishtinë.

Aliu,M .(1991),“ Zhvillimi i disa karakteristikave morfologjike dhe motorike të popullatës shkollore dhe ndryshimet në ato karakteristika në varshmëri me moshën kronologjike“, Disertacion doktorature, Sarajevë.

Çitaku,F,.(1981).Hulumtim në hapësiren motorike në segmente të forcës, të shpejtësisë dhe të precizitetit, i ka realizuar me 118-sportistë aktiv (hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe të asaj federative*.Elan, Prishtinë.

Zeqa, V. (2004) Struktura faktoriale dhe relacionet ndërmjet disa dimensioneve antropometrike dhe aftësive të hendbollit,punim magjistrature,UP FKFS,Prishtinë.

Myrtaj, N. (2007) Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në transformimin e aftësive lëvizore motorike te të rinjtë e moshës